

STATUTI
I Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
DEPOO KAMERA SH.P.K.

Parashikimet e këtij Statuti zbatohen për një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK).

Në këtëstatut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar;
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë;
- "QKB" – Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

KREU I
Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Më datë 18.09.2024 unë i nënshkruari: Erald CENKO lindur në Korçë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i kartës së identitetit I80412090N; do të regjistroj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

DEPOO KAMERA SH.P.K.

Neni 2
Objekti

Fusha e veprimitarisë do të jetë tregti me shumicë dhe pakicë, Kamera sigurie, Sisteme alarmi, sisteme muzike ,Kabell rg59, Kabell lan, Kabell audio, Kabell korenti, Kompjutera , HDD, Ram Kasa kompjuteri, Laptopë ,Karikues laptopi, Monitore ,Mausa, Tastjera ,Fisha usb, Fishë korenti, Fishë vga,dvi, Fishë hdmi,Telefona celulare/tableta,Samsung,Iphone; Xiaomi ,Ekrane telefoni ,Karikues telefoni,Kasa telefoni,Paisje te tjera elektronike, Montim, Instalim, servis dhe mirembajtje, Instalim i kabujve elektrik, Instalim i paisjeve elektrike, Kamera sigurie, Sisteme alarmi, Sisteme muzike, Rrjete kompjuterike, Formatim kompjuteri, Montim asamblim kompjuteri, Riparim kompjuteri ne motherboard, Riparim telefonash, Nderrim ekranit

Neni 3
Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar.

Neni 4

Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në Tiranë në adresen: Rr:Hermelika; Nd.1, H.31, Ap.20, Yzberisht, Kashar, kod postar 1050.

KREU II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali fillestari i shoqërisë do të 100 (njëqind) lekë të ndarë në 1 kuotë me vlerë nominale 100 lekë për kuotë cilë zotërohet nga ortaku i vetëm Erald CENKO.
Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashegimie.

KREU III

Organet Vendimarrëse dhe Drejtuese

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqerisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e ortakëve është përgjegjesë për marrjen e vendimeve për shoqërine për çeshtjet e mëposhtme:

- ndryshimet e statutit;
- emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të eksperteve kontabël të autorizuar;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimitarës;
- zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- çeshtje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblene e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si perfaqësues i ortakëve në asamblenë.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas paragrafit te pare të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, pavarësisht parregullësisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çeshtje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare ", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tre të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicen e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çeshtje të tjera si :

- emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;

- emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - përcaktimin e shpërblimeve
 - përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqerisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nesë asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- ç) dhënien ose jo të përfitimeve te reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizike si administratore të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtoritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në QKB.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëme, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Z. Erald CENKO është Administrator i kësaj shoqërie

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) përfaqësojne shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisin dhe nënshkrujnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë sëveprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrasamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) kryejne regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për QKB;
- e) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 15

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të treteve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, administrator detyrohet:

- të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdis;

- të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në keto dispozita;

- të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

- të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqerisë;

Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, pergjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave të këtij nenit, është i detyruar t'i dëmshpérbleje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua.

Në mënyrë të veçante, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuar, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

- u kthen ortakëve kontributet;

- u paguan ortakëve interesa apo dividende;

- u shpérndan aktivet shoqërisë;

- lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjëndjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte astësi paguese për të shlyer detyrimet;

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqerisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkësë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

KREU IV **Viti finansiar-ekspertet**

Neni 16 **Viti Financiar**

16.1. Viti finansiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Përashtimi i vitit i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllt me 31 Dhjetor.

**Neni 17
Ekspertet**

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqerisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij, nëse kompania plotëson kushtet ose për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerjen e rezultatit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

**KREU V
Prishja -riorganizimi i shoqërisë**

**Neni 18
Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatore dhe shënuar nëçdo dokument të nxerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqli ne likuidim e siper".

Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftësisë paguese, me përashtim të rasteve kur është nisur një procedure falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19
Riorganizmi i shoqerise bashkimi-ndarja**

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes së Pergjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 date 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20
Baza Ligjore**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË

DEPOO KAMERA SH.P.K.

Erald CENKO

